



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 16 tetor 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Vladimir Todoroviq dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Kolë Berisha.

Të pranishëm: Lumnije Murati – ZPRK, Lorik Bajrami – Çohu, Georgi Rupchev – EU – AC projekt, Afrim Atashi – AKK, Mentor Berovci – AKK, Eduard Pesendorfer – OSBE, Dardan Rexhepi – OSBE, Reshit Gashi - NDI dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga Staf i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 shtatorit 2009;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin kundër korrupsionit;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 22 shtatorit 2009

Procesverbali u miratua pa vërejtje

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin kundër korrupsionit

Kryetari para Komisionit i paraqiti propozimamendamentet për miratim nga ana Komisionit. Propozimamendamenti 12, pika 2, mbetet si në Projektligj.

Bajram Kosumi, duke iu referuar nenit 18, paragrafi 5, pyeti: çfarë ndihme policia mund t'i ofrojë Agjencisë?

U diskutua propozimamendamenti 14, neni 18, paragrafi 5 dhe shtohet një paragraf i ri që formulohet si *“Sipas nevojës Agjencia mund të kërkojë nga Policia asistencë për përmbushje të detyrave”*.

Propozimamendamenti 15, neni 19, mbetet si në Projektligj.

Bajram Kosumi duke iu referuar nenit 20, kërkoj që ky nen të specifikohet, sepse ashtu si është në Projektligj është shumë i gjerë, prandaj duhet të specifikohet *“ për rastin që është në hetim “*.

Selviqe Halimi, duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi se bankat nuk lejojnë qasje në xhirrollogari dhe ceku se vetëm me kërkesën e policisë dhe të prokurorisë mund të kontrollohen.

Ibrahim Makolli, në diskutimin e tij iu referua nenit 20 dhe tha se nuk mund të thuhet *“i detyron”*, sepse ky neni i jep të drejtë Agjencisë që të kërkojë informacione, e që kjo bie në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Duke shtuar se kjo është shkelje e privatësisë.

Bajram Kosumi, në fjalën e tij të sërishme propozoi të shtohet një paragraf që do ta kufizonte Agjencinë, se të dhënat e kërkuara nuk mund të jenë në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe të formulohet *“Të dhënat sipas paragrafit 1 të këtij neni, që kërkohen nga Agjencioni për rastin konkret duhet të jenë në përputhshmëri me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Adem Salihaj, propozoi që formulimi të jetë *“Veprimet sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të jenë në kundërshtim me ligjet në fuqi”*.

Adem Hajdaraj, duke iu referuar nenit 20, paragrafi 2, tha se duhet të mbetet si në Projektligj, të mos ndryshohet.

Me propozimin e kryetarit, neni 22 kalon në Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Ibrahim Makolli, duke iu referuar nenit 24 propozoi të parashihet një mekanizëm i sanksionimit, që do të parashihte kohëzgjatje edhe pas lëshimit të pozitës paraprake të zyrtarit, në mënyrë që të mos ketë funksione të tjera. Kjo do t'i kufizonte zyrtarët që kanë ushtruar funksione të rëndësishme - që kanë qenë sekret shtetëror.

Adem Salihaj, propozoi që neni 24 të formulohet si “ *Zyrtarët e agjencisë, çdo person i punësuar nga Agjencia, si dhe të gjithë personat që vihen në dijeni për sekretin zyrtar gjatë bashkëpunimit me Agjencinë, janë të detyruar ta ruajnë si sekret çdo informacion që kanë mësuar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, që konsiderohet informacion sekret*”.

Ibrahim Makolli - Shtoi se duhet të gjenden mekanizma që çdo rrjedhë e informacionit që del nga Agjencia duhet të hetohet.

Neni 24 plotësohet “ *Identiteti i raportuesit të rasteve të korrupsionit është sekret, përveç rasteve kur ai ka dhënë pëlqimin me shkrim që identiteti të zbulohet*”.

Me amendamentet e miratuar nga Komisioni Projektligji procedohet për shqyrtim dhe miratim në një nga seancat e ardhshme plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Lidhur me këtë pikë nuk pati debat, shtyhet për mbledhjen e radhës.

Të ndryshme

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të Projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe vlerësoi se Projektligji ka bazë juridike në përputhje me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Procesverbalin e hartoi
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni